



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:055355

Datë: 13.05.2024

Numri i dokumentit: 05675782

P.nr.106/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjyquese Qëndresa Tahiri Islami, me bashkëpunëtoren profesionale Edita Koliqi, në lëndën penale ndaj të pandehurit: A.A, për shkak të veprave penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3, pika 3.2 lidhur me paragrafin 2 të Kodit (Nr. 06/L-074) Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*) dhe veprës penale: Privimi i kundërligjshëm i lirisë nga neni 193 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së, sipas Aktakuzës PP.II.nr.259/24, të datës 12.04.2024 të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 29.04.2024, në mungesë të Prokurorit të Shtetit Arjan Xhema, të dëmtuarës Q.K, mbrojtësit të viktimave Muhamet Pervetica, si dhe të pandehurit A.A dhe në praninë e mbrojtësit të pandehurit, av. Bashkim Mehana, me datë 30.04.2024 shpalli publikisht, ndërsa më datë 13.05.2024, e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

A.A, me nofkën “...”, nga i ati P..., e ëma E..., e vajzërisë S..., i lindur me datë, në V..., me adresë të vendbanimit në rrugën “.....” në V..., beqar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal të identifikimit, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

I

SEPSE:

Me datë 12.02.2024 rreth orës 13:30 min në Shupkocv – Mitrovicë, saktësisht në motel “Dardani” me dashje dhe me qëllim të shkaktimit të lëndimeve trupore të dëmtuarës – partneres intime (viktimë e ndjeshme) Q.K, në mënyrë çnjerëzore dhe torturuese dhe atë me një mjet të rrezikshëm që mund të shkaktoj lëndime të rënda trupore si pasojë e mosmarrëveshjeve paraprake, dhe atë xhelozisë se e njëjta shoqërohet me persona tjerë ashtu që deri sa kanë qenë duke qëndruar brenda në motel i pandehuri fillon ta godet me kablllo elektrike si dhe qelës të birrave, pastaj e djegë me shkrepëse në pjesë të ndryshme të trupit duke i shkaktuar plagë dhe atë në gjunjë, pjesën nën gjunjë, duar, shpinë, gjoks si dhe në pjesë tjera të trupit, e që për pasojë të goditjeve e dëmtuara pëson lëndime dhe atë gërvishtje dhe mavijosje në krahun dhe këmbën e djathtë, si dhe në të gjunjët dëmtime këto të natyrës së lehtë trupore me pasoja të përkohshme në shëndetin,

- Me këtë ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3, pika 3.2 lidhur me par.2 të KPRK-së.

II

Me datë 12.02.2024 rreth orës 13:30 në Shupkocv – Mitrovicë, saktësisht në motel “Dardani” me dashje dhe në mënyrë të kundërligjshme e privon nga liria të dëmtuarën – partnere intime (viktimë e ndjeshme) Q.K, në mënyrë mizore dhe rezulton me dëmtime trupore dhe atë me mjet të rrezikshëm që mund të shkaktoj lëndime të rënda trupore, si pasojë e mosmarrëveshjeve paraprake xhelozisë se e njëjta po shoqërohet me persona të tjerë ashtu që deri sa kanë qenë duke qëndruar në motel, i shkakton dhunë duke e goditur me kablllo elektrike, çelës të birrave si dhe duke e djegur me shkrepës në pjesë të ndryshme të trupit, dhe në një moment e dëmtuara arrin të marrë telefonin e saj i dërgon mesazhe motrës së saj “pash Zotin hajde merrem me B..., dhe hajdeni vet mos e thirreni policin”, por pavarësisht se burri i motrës arrin të vijë tek moteli, i pandehuri nuk e lejon të largohet nga aty dhe e mban të mbyllur deri të nesërmen datë 13.02.2024 rreth orës 15:40 min kur dhe largohet nga aty.

-Me këtë ka kryer veprën penale: Privimi i kundërligjshëm i lirisë nga neni 193 par.4 lidhur me par.2, nën-par.2.1 dhe 2.2 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të neneve: 1, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42, 69, 70, 71, 76, 78 lidhur me nenin 185 dhe 193 të KPRK-së, dhe neneve: 364, 449, 452, 462 të KPP-së, të pandehurin, e:

G J Y K O N

Për veprën penale si në pikën I:

-DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej tetë (8) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për veprën penale si në pikën II:

-DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjykata, në mbështetje të nenit 76 të KPRK-së, të pandehurit A.A, i:

S H I P T O N

-DËNIM UNIK në kohëzgjatje prej një (1) viti e tre (3) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

-Të pandehurit, i vazhdohet masa e paraburgimit nga data 30.04.2024 deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë.

-Të pandehurit A.A, koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 16.02.2024 e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit i llogaritet në dënimin e shqiptuar unik me burgim.

-Obligohen i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej njëzet (20) euro dhe në emër të Fondit për Kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, ndërsa në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumën prej njëzet (20) euro. Të gjitha këto i akuzuarit është i obliguar që t'i paguajnë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

-Pala e dëmtuar Q.K për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m i

Aktakuza:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.259/24, të datës 12.04.2024, ndaj të pandehurit A.A, për shkak të veprave penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3, pika 3.2 lidhur me par.2 të KPRK-së dhe veprës penale: Privimi i kundërligjshëm i lirisë nga neni 193 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Me datë 29.04.2024, gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në praninë e palëve, prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Arjan Xhema, të dëmtuarës Q.K, mbrojtësit të viktimave Muhamet Pervetica, si dhe të pandehurit A.A me avokatin mbrojtësi sipas autorizimit, av.Bashkim Mehana.

I pandehuri, në seancën e shqyrtimit fillestar, pas njoftimit nga gjykata, me të drejtat e tij në këtë fazë të procedurës penale, është deklaruar dhe ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës së prokurorisë. Ka kërkuar falje ndaj të dëmtuarës duke theksuar se për shkaqe xhelozie ka ardhur deri te kjo, për shkak të dashnisë që ka pasur ndaj saj, ka shprehur keqardhje për atë që ka ndodhur dhe ka premtuar që më nuk do të bëjë probleme ndaj të dëmtuarës apo ndonjë problem tjetër.

Gjykata ka marrë mendimin e palëve mbi pranimin e fajësisë nga i pandehuri A.A.

Prokurori Arjan Xhema, fillimisht i propozoi gjykatës që pranim e fajësisë të deklaruar nga i pandehuri ta miratoj, pasi që është bërë në mënyrë vullnetare, konform dispozitave të nenit 242 të KPP-së, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe se pranimi i fajësisë gjen mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Për të pandehurin nga gjykata ka kërkuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Mbrojtësi i viktimave Muhamet Pervetica, ka propozuar që gjykata ta pranoj pranimin e fajësisë të deklaruar nga i pandehuri, ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

E dëmtuara Q.K, fillimisht ka theksuar se nuk pranon kërkim faljen nga ana e të pandehurit, ndërsa sa i përket pranimit të fajësisë ka deklaruar se e lë në vlerësim të gjykatës.

Avokati mbrojtës i të pandehurit, av.Bashkim Mehana, ka konsideruar se pranimi i fajësisë nga i mbrojturi i tij është bërë në konsultim të mjaftueshëm me të si mbrojtës, me vullnet të lirë dhe i vetëdijshëm për natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe një pranim i tillë ka mbështetje edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, andaj gjykatës i propozoi që ta bëjë miratimin e fajësisë. Lidhur me rrethanat e matjes së dënimit, ka propozuar që si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë, shprehja e keqardhjes, pendimi i thellë, premtimi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, personaliteti i tij, ashtu që të njëjtit të i shqiptohet një sanksion penal sa më i butë.

Gjetjet e Gjykatës:

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilin e ka deklaruar i pandehuri A.A, në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e pranimit të fajësisë për të pandehurin. Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë, siç janë: Raporti fillestar i incidentit i datës 16.02.2024; Raporti i policit i datës 16.02.2024; Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëmtuarës Q.K i datës 16.02.2024 dhënë në hetuesi dhe i datës 04.03.2024 në prokurori; Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitares Q.Z i datës 21.02.2024; Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit B.Z i datës 21.02.2024; Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit V.B i datës 22.02.2024; Procesverbali mbi marrjen në pyetje për të pandehurin A.A i datës 16.02.2024 dhënë në hetuesi dhe i datës 15.03.2024 dhënë në prokurori; Dokumentacioni mjekësor për të dëmtuarën Q.K; Urdhri për mbrojtjen e përkohshme emergjente i datës 16.02.2024; Ekspertiza mjeko – ligjore e datës 10.03.2024; CD-ja; Foto albumi nga shkresat e lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese, e që në bazë të tyre dhe pranimit të fajësisë nga i pandehuri, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprat penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3, pika 3.2 lidhur me par.2 të KPRK-së dhe Privimi i kundërligjshëm i lirisë nga neni 193 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është bërë në mënyrë vullnetare, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Gjykata i'a kishte tërheq vërejtjen të pandehurit se pas pranimit të fajësisë nuk mundet të shfrytëzojnë të drejtën në ankesë, lidhur me bazën për gjendjen faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësinë e

kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësinë për paraqitjen e provave tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është një rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë. Gjykata gjithashtu ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as ndonjë gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë nga i pandehurit dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri A.A është përgjegjës për veprat penale për të cilat akuzohet: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3, pika 3.2 lidhur me par.2 të KPRK-së, për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet dhe veprën penale: Privimi i kundërligjshëm i lirisë nga neni 193 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së, për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin A.A, ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-ës, e si rrethanë rënduese, gjykata ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale, i pandehuri ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës veprat penale, i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij, veprën penale e kishte kryer me dashje direkte dhe me motive të ulëta. Gjithashtu, si rrethanë rënduese është marrë parasysh kontributi esencial i të pandehurit në kryerjen e veprave penale, rrezikshmërinë e lartë të shoqërisë nga këto vepra penale, motivin e kryerjes së veprave penale pasi që i pandehuri këto vepra penale i kishte kryer për shkaqe xhelozie që kishte pasur ndaj të dëmtuarës, pastaj mënyra e kryerjes së veprave penale, *e që janë bërë në mënyrë çnjerëzore dhe torturuese, duke e goditur me kablllo elektrike, qelës të birrave, e pastaj duke e djegur me shkrepëse në pjesë të ndryshme të trupit* duke e torturuar dhe duke i shkaktuar të dëmtuarës dhimbje shumë të madhe, pastaj mjetet me të cilat i ka kryer këto vepra penale si kablllo elektrike, qelës të birrave dhe shkrepës duke u vlerësuar si mjetë me të cilat mund të shkaktohen demtime me pasoja të rënda për të demtuaten, rrethanë tjetër rënduese gjykata e mori parasysh edhe sjelljen e mëparshme të kryerësit pasi që i njëjti është i dënuar edhe me aktgjykim të plotfuqishëm P.nr.411/20 i datës 31.01.2023 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, po ashtu për veprën penale të Lëndimit të lehtë trupor.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese, ka marrë për bazë faktin se i njëjti ka treguar sjellje të mira, premtimin e dhënë nga i pandehuri në seancë se më nuk do të përsërisë veprime të tilla, keqardhjen e shprehur për rastin e ndodhur, kërkim faljen palës së dëmtuara, ka bashkëpunuar plotësisht me organet e rendit dhe drejtësisë që nga fillimi i procedurës kundër tij, duke kontribuar kështu në zbardhjen e shpejtë dhe të plotë të këtij rasti. Ndërsa, si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin është vlerësuar pranimi i fajësisë në tërësi për veprën penale që në hapje të shqyrtimit fillestar të çështjes.

Gjykata, në kuptim të nenit 71 të KPRK-së ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit sa i përket veprës penale Privimi i kundërligjshëm i lirisë, duke u bazuar në faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë dhe se pranimi i fajësisë është rrethanë ligjore, në kuptim të nenin 71 par.1, nën-par.1.3 të KPRK-së, që gjykata të shqiptojë dënim nën minimumim e dënimit të paraparë për këtë veprë. Megjithatë, me rastin e zbutjes së dënimit, janë respektuar kufijtë e zbutjes sipas nenit 72 par.1, nën-par. 1.5 të KPRK-së, që në rastet e tilla, kur minimumi i dënimit për veprën penale është 1 vjet, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj. Ndërsa sa i përket veprës penale të përshkruar në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, gjykata vlerësoj se i njëjti është recidivist, pasi që edhe më parë ka qenë i dënuar për veprën penale të Lëndimit të lehtë trupor me aktgjykim të formës së prerë, e duke i pasur për bazë këtë gjykata nuk ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit sa i përket veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3, pika 3.2 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit unik me burgim, ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 par.1 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Masa e paraburgimit:

Gjykata, me rastin e shpalljes së aktgjykimit, të pandehurit A.A i'a ka vazhduar masën e paraburgimit deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë. Në lidhje me këtë Gjykata ka lëshuar vendim të veçantë ku edhe i ka dhënë arsyet për një vendim të tillë, e të cilat tregojnë mjaftueshëm se rreziku për përsëritjen

e veprës penale është real dhe vazhdimi i masës së paraburgimit deri në plotëfuqishmërinë e kësaj lënde është i domosdoshëm.

Kërkesa pasurore juridike:

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, dhe të dëmtuarën e ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko – civil në kuptim të nenit 462 të KPP-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës dhe ato për paushall gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 358, 364, 449, të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.106/2024, datë 13.05.2024

Bashkëpunëtore profesionale

Edita Koliqi

Gjyqtarja e vetme gjyqesore

Qëndresa Tahiri - Islami

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.